

VENDIM
Nr.32, datë 22.4.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PURO
ENERGY STEBLEVA” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa a, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa a, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa a, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi:

- Paraqitjen e aplikimit konform përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “PURO ENERGY STEBLEVA” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta